REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisoni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

Nr 1530 Prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Fushë-Arrëz, më 05.06.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e Projektvendimit nr. 16, datë 05.06.2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për një ndryshim në VKB Nr.60, datë 23.12.2024, "Për Miratimin e nivelit të pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025".

Analiza ligjore: Ky Projektvendim eshte hartuar në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64 germa "j", neni 55, Ligjit 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", Ligjit nr. 35/2023, "Per kompetencat per caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimive te te punesuarve ne Institucionet e administrates publike, si dhe pages baze minimale ne shkalle vendi, VKM nr.503, date 1.8.2024, per disa ndryshime ne VKM nr. 328 date 31.5.2023, "Per klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njesive te vetegeverisjes vendore, per efekt page, dhe caktimin e kufijeve te pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e te punonjesve adminisrtative te njesive te veteqeverisjes vendore", VKM nr. 422, date 26.06.2024, per nje ndryshim ne VKM nr. 326, date 31.5.2023, "Per pagat e punonjesve mbeshtetes dhe punonjesve te tjere të specialiteteve te ndryshme ne disa institucione te administrates publike", VKM nr. 425, date 26.06.2024 "Për miratimin e struktures dhe te niveleve te pagave te punonjesve mesimore dhe te punonjesve te tjere jo mesimore ne Institucionet arsimore dhe ne Institucionet plotesuese te sistemit arsimore parauniveristar", VKM nr. 419, date 26.06.2024, "Per miratimin e vlerave per secilin element perberes te pages bruto mujore te punonjesve te sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin "VKM nr. 502, date 1.8.2024, per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr. 325, date 31.05.2023, "Per miratimin e struktures se pagave, nivelit te pagave dhe shtesave te tjera

mbi page te zevendesministrit, funksionareve te kabineteve, prefektit, nenprefektit, nepunësve civile dhe nepunesve te disa institucioneve te adminstrates publike", si dhe VKM nr. 113, date 1.3.2023, "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi"

Situata aktuale e funksionit:

Fondet e trashëguara paraqiten sipas tabelës së mëposhtme në lekë:

Nr.	*Përshkrimi*	*Viti*
		2025
1	Transferta e pakushtëzuar e trashëguar	30,748,190
Shuma 1		**30,748,190**
2	Të ardhura të trashëguara	23,755,217
Shuma 2		**23,755,217**
Totali 1+2		**54,503,407**

Situata financiare: Sipas Projektit te paraqitur nga Drejtoria e Finances, fondet e trashëguara ndahen: Transferta e pakushtezuar e trasheguar, 30,748,190 lekë; Te ardhura te trasheguara, 23,755,217 lekë: Totali 54,503,407 lekë

Drejtoria / Sektori përgjegjës:
Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë vendimin dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Finances ose Drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Vendimi "Për Miratimin e nivelit të pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025" impakton jetën e disa shtresave, kategorive dhe zhvillimin e territorit të bashkise.

Projektvendimi nuk kerkon degjese publike

Komisioni i Përhershëm për " Ekonomi dhe Financë", i mbledhur me datën 05/06/2025, shqyrtoi projekvendimin nr. 16 datë 05.06.2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me

propozimin për një ndryshim në VKB Nr.60, datë 23.12.2024, "Për Miratimin e nivelit të pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025".

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
   a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
   b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Besjana Marku **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I EKONOMISË FINANCË BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK

Nr. 1530 prot.

Fushë-Arrëz, më 05.06.2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Relacion i Komisionit te Ekonomise Finance Buxhetit Mbikqyrjes Financiare Planifikimit te Zhvillimit Strategjik mbi Projektvendimin për një ndryshim në VKB Nr.60, datë 23.12.2024, "Për Miratimin e nivelit të pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025".

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, u mblodh sot më, 05.06.2025, Komisioni i Ekonomisë Finances Buxhetit dhe Mbikqyrjes Financiare me anetare : Franc Doda (Kryetar i komisionit), Besjana Marku (Sekretare e Komisionit), Zef Cara (Anetar i Komisionit), Valentin Doci (Anetar i Komisionit), Valentina Lleshaj (Anetare e Komisionit). Gjithashtu i pranishem ishte, Pergjegjesi i Finances Z.Dritan Lika dhe Pergjegjesjs e Burimeve Njerezore, Znj. Fatjona SELIMAJ te cilet dhane shpjegime per projektin e mësipërm.

Pergjegjesjs e Burimeve Njerezore, Znj. Fatjona SELIMAJ, shpjegoi se bazuar në ligjin 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Urdherin e Kryetarit te Bashkise nr.724/1, date 28.05.2025, si dhe duke marre shkas nga nevoja emergjente e krijuar, kerkojme nga Keshilli Bashkiak miratimin e nivelit te pagave per punonjesit e shtuar ne Strukturen Organizative per vitin 2025 ne Sektorin e Sherbimeve Publike dhe konkretisht;

Punonjes Sherbimesh per mirembajtje objektesh, punonjes te shtuar 5, paga baze eshte 40.000 leke/muaj, vjetersi 1% mbi pagen, per çdo vit pune (jo me shume se 25 vjet).

Gjithashtu pagesa e tyre do filloje me miratimin e nivelit te pagave nga ana Juaj dhe emerimit ne pune te tyre! Efektet financiare te vendimit qe do te merret pasi projektakti te kaloje ne mbledhjen jashte radhe te keshillit bashkiak, date 9 Qershor 2025 (shkas nga nevoja emergjente e krijuar) fillojnë me emerimin ne pune deri me 31 Dhjetor 2025.

Pa diskutime te metejshme anetaret e komisionit rane dakord me shumice votash duke e derguar projektvendimin per shqyrtim te metejshem dhe miratim ne mbledhjen Plenare te dates 09.06.2025.

Duke kerkuar bashkepunimin tuaj!

PER KOMISIONIN:

Kryetar		**Sekretar**
Franc DODA	Zef Cara Jun/ Valentin Doçi	**Besjana Marku**